

PROCESVERBAL
nga seanca e 33-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 16.10.2023

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, L Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi profesional: Maja Damevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Emilija Janevska, Ivona Mufisheva, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Z. Petrushevski hapi seancën e 33-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 12:50 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave në katin e 2-të.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga vazhdimi i parë i seancës së 31-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 9.10.2023.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 32-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 9.10.2023.
3. Propozim - akvendim për vazhdimin e afatit për vendimarrje pas procedurës së iniciuar për heqjen e lejes të SHTR Radio Kanal 77 SHPKNJP Shtip.
4. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR G-TV TELEVISION SHPKNJP Gostivar, për shkelje të nenit 50, paragrafi (3) të LSHMAAV dhe nenit 19 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve.
5. Propozim për dhënie miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik - mallra: Karburant për nevojat e Agjencisë .
6. Ankesë nga e punësuarë në Shërbimin Profesional të Agjencisë kundër Vendimit ark. nr.04-3579/1, datë 29.9.2023.
7. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin e propozuar nga vazhdimi i parë i seancës së 31-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 9.10.2023, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin e propozuar nga seanca e 32-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 9.10. 2023, me tekstin e propozuar.

Pika 3

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin-aktvendimin për vazhdimin e afatit për vendimmarrje pas procedurës së iniciuar për heqjen e lejes të SHTR Radio Kanal 77 SHPKNJP Shtip. Ai ka sqaruar se në seancën e kaluar të 32-të, Këshilli ka ardhur në përfundim për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes të SHTR Radio Kanal 77 SHPKNJP Shtip, me çka Këshilli në afat prej 15 ditësh duhet të vendos nëse do ta ndërpresë procedurën ose do të marrë Vendim për heqjen e lejes. Ligji parasheh që nuk është e nevojshme të bëhet një kontroll i dytë, respektivisht mbikëqyrje ndaj transmetuesve që kanë shkelur dispozitat e ligjit dhe parashihet që t'i hiqet leja. Por është krijuar praktikë në Agjenci gjithmonë të bëhet mbikëqyrje kontrolli për të konstatuar nëse shkeljet janë mënjanuar ose jo dhe më pas Këshilli merr vendimin përkatës. Duke qenë se në këtë rast vetë analiza e incizimeve nga ky transmetues është mjaft e ndërlikuar dhe kërkon një periudhë më të gjatë kohore, sipas Ligjit për Procedurë të Përgjithshme Administrative ekziston mundësia që të shtyhet miratimi i vendimit të organit, por jo më gjatë se 30 ditë. Ai theksoi se Agjencia duhet gjithmonë të udhëhiqet nga interesat e palës në këtë rast transmetuesit, dhe sipas LPPA, organet publike siç është ASHMA janë të orientuara drejt realizimit të të drejtave dhe interesave të palëve, respektivisht gjithmonë duhet të shikojnë kushtet më të favorshme për transmetuesit. Gjithashtu, në pajtim me nenin 11 të LSHMAAV, Agjencia përbëhet nga dy organe, Këshilli dhe Drejtori, gjegjësisht Shërbimi Profesional, dhe gjatë miratimit të vendimit përfundimtar, Këshilli duhet të marrë informacionin përkatës nga drejtori, gjegjësisht shërbimi profesional, në mënyrë që të jetë në gjendje të marrë vendimin përkatës. Për këtë arsye propozohet që afati i vendimmarrjes së Këshillit të vazhdohet për jo më gjatë se 30 ditë dhe menjëherë pas zbatimit të analizës Këshilli do të informohet, edhe pse afati mund të jetë më i shkurtër dhe do të mbahet seancë në të cilën Këshilli do të marrë vendimin përfundimtar.

Z. Petrushevski tha se për të personalisht afati i propozuar jo më gjatë se 30 ditë është i pranueshëm për arsye se masa e propozuar është shumë serioze për çdo medium. Ai personalisht shpreson që nuk do të përsëritet mbikëqyrja e mëparshme ku janë konstatuar shumë shkelje dhe dukej sikur ishte bërë qëllimisht. Tjetër është të ketë gabim teknik, por ka pasur shumë shkelje. Megjithatë, ai mendon se mediumit duhet t'i jipet mundësia që të respektojë Ligjin dhe shpreson që herën tjetër ku Këshilli do të marrë vendim, ta ndërpresë procedurën për heqjen e lejes. Ai pret që kjo të ndodhë sepse nuk dëshiron që të jetë ndryshe.

Z. Fidanoski deklaroi se do ta mbështesë propozimin dhe pyeti nëse, duke respektuar procedurat ligjore, do të mjaftojnë 30 ditët e propozuara që Shërbimi të përgatisë Raportin dhe ta dërgojë në Këshill për rishqyrtim.

Shërbimi u përgjigj se 30 ditët janë të mjaftueshme për hartimin e analizës dhe mbikëqyrja që duhet të kryhet për të verifikuar nëse transmetuesi ka hequr pengesat ligjore për kryerjen e veprimtarisë.

Këshilli i Agjencisë me 5 vota "pro" dhe një votë abstenim nga z.Trajçev miratoi Vendim për vazhdimin e afatit (19.10.2023) për miratimin e vendimit nga Këshilli i Agjencisë për Propozimin për inicimin e procedurës për heqjen e lejes të SHTR Radio Kanal 77 SHPKNJP Shtip PA1 nr.08-331 datë 5.10.2023, për jo më gjatë se 30 ditë për shkak të kompleksitetit të lëndës, gjegjësisht specifikës së mbikëqyrjes së jashtëzakonshme programore që duhet t'i kryejë për të verifikuar nëse transmetuesi ka hequr pengesat ligjore për kryerjen e veprimtarisë.

Për Aktvendimin e miratuar do të njoftohet transmetuesi në pajtim me nenin 94 paragrafi (3) të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm duhet ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 4

Udhëheqësja e Sektorit për Çështje Programore, mr.Emilija Janevska ka shpjeguar Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR G-TV TELEVISION SHPKNJP Gostivar, për shkelje të nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe nenit 19 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve. Ajo ka shpjeguar se shkelja është konstatuar me mbikëqyrje të rregullt në gusht të vitit 2023, e cila nuk ka respektuar rregullat për mbrojtjen e të miturve. Në disa përmbajtje të transmetuara ditën e analizës, kryesisht programe artistike, transmetuesi nuk ka aplikuar sinjale paralajmëruese për mbrojtjen e të miturve, as para as gjatë transmetimit të përmbajtjeve. Për këto arsye, propozohet që transmetuesit t'i shqiptohet masë vërejtje publike me afat respektimi prej 20 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit dhe më pas të kryhet mbikëqyrje kontrolli.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.10-3350/1 të datës 1.9.2023 dhe njëzëri konstatoi se SHTR G-TV TELEVISION SHPKNJP Gostivar t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe nenit 19 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve sepse më 10 gusht 2023, janë transmetuar disa programe artistike pa u shënuar me sinjalistikë për mbrojtjen e të miturve para fillimit dhe gjatë transmetimit të tyre.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, është udhëzuar në afat prej 20 ditësh nga data e pranimit të Aktvendimit, të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe Rregulloren për mbrojtjen e të miturve.

Spektori për Çështje Juridike dhe Furnizim Publik të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për Çështje Programore pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 5

Udhëheqësja e Sektorit për Çështje Juridike dhe Furnizim Publik, Cvetanka Mitrevska ka shpjeguar Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - mallra: Karburant për nevojat e Agjencisë. Ajo ka shpjeguar se Agjencia posedon 5 vetura zyrtare që përdoren për qëllime zyrtare. Gjithashtu, në selinë ku ndodhet Agjencia është montuar dhe agregat i cili përdoret në rast të ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike nga rrjeti i rregullt i energjisë elektrike. Prandaj, është e nevojshme të realizohet kjo procedurë, e cila është paraparë në Planin Vjetor për furnizime publike për vitin 2023 të Agjencisë, ndërsa mjetet janë siguruar me Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023, respektivisht do të sigurohen me Planin Financiar të Agjencisë për vitin 2024, sepse kontrata që do të rezulton nga ky furnizim do të lidhet për një periudhë 2 vjeçare. Furnizimi do të kryhet si procedurë e hapur e thjeshtuar dhe të gjitha të dhënat e nevojshme gjenden në materiale.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi zbatimin e procedurës për furnizim publik - mallra: Karburant për nevojat e Agjencisë.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën-mallra: Karburant për nevojat e Agjencisë është paraparë dhe është në përputhje me Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2023 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-4766/1 të datës 23.12.2022, ndërsa mjetet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023, respektivisht do të sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për vitin 2024.

Pika 6

Z. Petrushevski në lidhje me Ankesën (kundërshtimin) nga e punësuarja në Shërbimin Profesional të Agjencisë kundër Vendimit nr.04-3579/1 të datës 29.9.2023, sqaroi se punonjësja nga Këshilli kërkon që të caktohet në vendin e punës Udhëheqëse e Sektorit për Çështje Juridike dhe Furnizim Publik dhe të marrë pjesë në seancë. Në lidhje me seancat, ka thënë se deri më tani është vendosur praktikë që të mos marrin pjesë të punësuarit kur bëhet fjalë për vendosjen e vendit të punës, dhe në këtë rast nuk bëhet fjalë për renoncim (largim) apo punësim dhe këtë pjesë nuk mund ta pranojë.

Z. Trajçevski sqaroi se sipas aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Agjencia është e obliguar që në afat prej 8 ditësh, i cili si afat është respektuar, të vendosë aplikuesen në vendin e punës sipas aftësimin të saj profesional. Sipas formimit profesional të aplikantit, ajo u vendos në vendin e punës Udhëheqëse e njësisë për çështje normativo-juridike dhe me këtë vendosje është respektuar vendimi i gjykatës dhe njëkohësisht kjo është pozita më e lartë e vendit të punës në pajtim me kualifikimin profesional që zotëron parashtruesi i ankesës. Për caktimin në një pozicion tjetër si bashkëpunëtor i lartë apo bashkëpunëtor, do të bëhet emërimi në një vend pune sipas përgatitjes profesionale, por do të ketë pagë më të ulët, edhe pse sipas aktvendimit të gjykatës, nuk është cekur paga, por vetëm përgatitja profesionale. Parashtruesi negocues nuk është i kënaqur me vendimin e Agjencisë dhe kërkon që të klasifikohet (vendoset) në vendin e punës Udhëheqës i Sektorit për Çështje Juridike dhe Furnizim Publik.

Kërkesa e saj thuhej edhe në padi, është refuzuar nga Gjykata e Apelit, pasi sipas sistematizimit udhëheqës i Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike duhet të ketë dhënë provimin e jurispodencës, të cilën bartësi i ankesës nuk e ka dhe gjithashtu ai nuk ka certifikatë për furnizim publik. Këto dy kushte parashtruesi i kërkesës nuk i ka dhe në përputhje me këtë nuk mund ai si drejtor ta vendosë në atë vend pune. Ai ka sqaruar se kjo ndarje e vendit të punës Udhëheqës i njësisë për çështje normativo-juridike është kryer në koordinim me zyrën e avokatëve që ka angazhuar Agjencinë. Ai thekson se aktgjykimi i gjykatës është zbatuar në tërësi sepse nuk ka mundësi tjetër që ai si drejtor të mos e zbatojë aktgjykimin e gjykatës.

Z. Petrushevski tha se Agjencia është e obliguar të zbatojë vendimin e Gjykatës së Apelit dhe është zbatuar, është caktuar në vendin e punës ashtu siç ka qenë më parë. Ankesa (kundërshtimi) është dërguar në Këshill, por nëse shikoni kompetencat e Këshillit, neni 18 nga LSHMAAV, do të shihet se Këshilli përveç kompetencave të tjera në lidhje me të punësuarit, jep miratim për punësimin dhe largimin e të punësuarve në Shërbimin Profesional të Agjencisë, që në këtë rast nuk është ashtu. Në pajtim me nenin 20 nga LSHMAAV, drejtori i Agjencisë, përveç kompetencave të tjera, vendos për punësimin dhe vendosjen në vende të punës të të punësuarve në Shërbimin Profesional të Agjencisë, që do të thotë se kjo kërkesë për vendosje është ekskluzivisht në kompetencë të drejtorit. Në këtë rast, ai mund të pranojë se Këshilli është disi vend ku një punonjës do të ankohej, por nëse shihet sipas kompetencave, kjo është e drejtë ekskluzive e drejtorit dhe për shkak të vendimit të zbatuar nga Gjykata e Apelit dhe për shkak të asaj që tha për nenin 20 të LSHMAAV, nuk mund të pranojë Kërkesën e të punësuarve që Këshilli të ndikojë në caktimin e vendit të punës Udhëheqës i Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik. Ai ka shpjeguar se është kundër këtij propozimi dhe për të ankesa (kundërshtimi) është i papranueshëm para së gjithash për shkak të kompetencave ligjore të drejtorit që nuk i japin të drejtë t'i thotë se si të veprojnë, por mund të thotë nëse ai është drejtor se çfarë do të bëjë. Ai shpjegoi se do ta thërriste të punësuarën personalisht, me të ose me udhëheqësit e tjerë për disa biseda, sepse kjo ka disa vite që po ndodh, pra paraqet problem për vetë të punësuarën, për drejtorin, për të punësuarit në Sektor, do të thotë një ngarkesë e pakëndshme që shqetëson atmosferën në Agjenci. Ai beson se një situatë e tillë mund të tejkalohet vetëm me bisedime, kur nuk ka bisedime, opsionet e fundit janë të ketë padi ose mundësisht e punësuar në shenjë revolte të largohet nga Agjencia. Ai nuk sheh zgjidhje tjetër, nuk është mirë të vazhdohet kështu. Ai do të diskutonte edhe më shumë, megjithëse e respekton vendimin e drejtorit sepse kjo është në kompetencë të tij dhe ai vendos se ku do të caktohen të punësuarit. Efikasiteti i Shërbimit Profesional është në kompetencën e tij, nëse punon mirë po ashtu edhe nëse nuk punon mirë përsëri ai është përgjegjës.

Z. Ajdini tha se edhe për të situata është e qartë, ata si Agjenci duhet të zbatojnë vendimet gjyqësore. Ai ka kërkuar shpjegim për një pjesë të shkresës nga Zyra e Avokatisë, ku thuhet se është shpallur revizion. Ai pyeti nëse parashtruesi ka paraqitur kërkesë tek revizioni, nëse Agjencia ka marrë ndonjë letër apo është përgjigjur? Ai pyet, sepse shkruan "Revizioni i shpallur si mjet juridik i jashtëzakonshëm nuk e anulon ekzekutimin.

Z. Trajçevski sqaroi se në vetë ankesën (kundërshtimin), parashtruesi i ankesës tregon se do të paraqesë ankesë formale në Gjykatën Supreme. Kur do të paraqesë ankesë, pra kur kërkon revizion, Agjencia nëpërmjet Zyrës së Avokatisë do të informohet, por ai sqaroi se deri më tani nuk ka pasur revizion të tillë. Ai beson se afati është 30 ditë nga aktgjykimi (verdikti) i

plotfuqishëm dhe se ai afat ende vazhdon. Deri më tani ka vetëm njoftim dhe nuk e di nëse do të dorëzohet.

Z. Ajdini deklaroi se do të jetë kundër kërkesës nga kundërshtimi i paraqitur në Këshill.

Z. Trajçev tha se pajtohet me atë që u tha, se situata të tilla zgjidhen gjithmonë me dialog dhe gjithmonë me bisedë mund të gjendet një gjuhë e përbashkët për të gjitha situatat dhe kushtet, sidomos për faktin se në gjykatë janë të humbura vendimet që sillen nga drejtori, më tej vijnë në Këshill. Ai po ashtu vëren se në materialet ka reagim nga Avokati i Popullit për mënyrën se si është zhvilluar dhe të gjitha këto situata tregojnë në atë se duhet vepruar pak më ndryshe, të gjendet një gjuhë e përbashkët sepse të gjitha situatat përfundojnë me një lloj marrëveshjeje. Ai beson se ky rast ka të bëjë më shumë me një lloj marrëdhënie personale, nuk hyn në atë se kush ka të drejtë dhe kush e ka gabim, por kur bëhet fjalë për investim të këtij lloji përpjekjeje të ndonjë të punësuar për të udhëhequr (kryer) procedura gjyqësore, shihet qartë se ai ndihet i kërcënuar. Ai nuk mund të hyjë në arsyet pse ka ardhur deri këtu, e vetmja gjë që do të donte të pyeste është se nëse është vepruar në pajtim me vendimin e Gjykatës së Apelit, i cili thotë të vendoset në vendin përkatës të punës dhe nëse është vepruar, nëse është ky vendi i punës përkatës nga të gjitha aspektet, nga aftësimi profesional, nga aspekti i pagës, nga aspekti i asaj që ka ndodhur më parë dhe tani me sistematizimin e ri që është miratuar, nëse nuk rrezikohet dhe pas marrjes së këtij vendimi, gjykata të konstatojë se nuk është vepruar drejt, përse nuk është përmbushur kjo që Gjykata e Apelit e kërkon nga Agjencia, gjegjësisht të caktohet në vendin përkatës të punës.

Z. Trajçevski u përgjigj se e punësuar është caktuar në pozitën më të lartë të vendit të punës, vend i lirë pune sipas kualifikimeve të saj profesionale. Ka vetëm edhe një vend pune, ai është Ndhmës Udhëheqës i Sektorit për Çështje Juridike dhe Furnizim Publik, në të cilin është mr. Ivona Mufisheva. Pozicioni aktual është më i lartë me pagë më të lartë, kështu që në tërësi është përmbushur vendimi i Gjykatës së Apelit. Për sa i përket mendimit të Avokatit të Popullit ai tha se nuk do të komentonte publikisht, por meqenëse punonjësja është ankuar për mobing, me kërkesë të Avokatit të Popullit dhe me kërkesë të Kryetarit të Qeverisë, është realizuar mbikëqyrje nga ana e Inspektoratit të punës i cili është kompetent për të përcaktuar nëse ka apo jo mobing. Në këtë drejtim, nga Inspektorati i Punës është konstatuar se nuk është kryer mobing ndaj të punësuarës. Dhe sipas kësaj, nëse do të kishte konstatim dhe konkluzion të tillë nga inspektorati i punës, do të kishte padi dhe që atëherë kanë kaluar më shumë se një vit e gjysmë.

Z. Petrushevski shpjegoi se kërkesa në Ankesë e të punësuarës është të vendoset në vendin e punës Udhëheqëse e Sektorit për Çështje Juridike dhe Furnizim Publik. Pyetja e tij ishte, a pranohet kjo kërkesë?

Këshilli i Agjencisë me tre vota kundër nga z. Petrushevski, z. Ajdini dhe znj. Mashoviq dhe 3 abstenime nga z. Trajçev, z. Fidanoski dhe z. Jançeski nuk e pranoi Ankesën (kundërshtimin) dorëzuar Këshillit të Agjencisë me nr.04-3579/2 datë 6.10.2023 kundër Vendimit ark.nr.04-3579/1 datë 29.9.2023, paraqitur nga udhëheqësi i njësisë për çështje normative-juridike në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Pika 7

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

Nr. 02-3741/6

26.10.2023

Shkup

Agjencia për Shërbime Mediatike

Audio dhe Audiovizuale

Kryetari i Këshillit,

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.